

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Misin Frangu me sek. juridike Ardita Tasholli, në çështjen kontestimore sipas padisë së paditëses Kompania e Sigurimeve [REDAKTUE], rruga [REDAKTUE], në Prishtinë, të cilen e përfaqson sipas autorizimit av. [REDAKTUE] e kunder të paditurit [REDAKTUE] rr. [REDAKTUE]. Ferizaj, baza e kontestit zhdamtimi në bazë të regresit më datën 12.04.2016 shpallë këtë.

### A K T G J Y K I M

Për shkak të padëgjushmeris/mosbindjes/

**APROVOHET**, kërkespadia e paditëses Kompania e Sigurimeve [REDAKTUE], rruga [REDAKTUE] A në Prishtinë, të cilen e përfaqson sipas autorizimit av. [REDAKTUE]

**OBLIGOHET**, i paditurit [REDAKTUE] nga Ferizaj [REDAKTUE] që paditësi tia kthej borgjin në shumen prej 140.00 Euro/Njëqind e dyzet euro/ në emrin të zhdamtimin në bazë të regresit si dhe shpenzime e procedures sipas llogaris qe do ti beje Gjykata në Procedure Permbarimore, të gjitha këto në afatë prej 15 ditësh nga dita e plotefuqishëris së këtij Aktgjykimi, nën kanosjen e egzekutimit të dhunshëm.

### A r s y e t i m

Paditsja Kompania e Sigurimeve [REDAKTUE], rruga [REDAKTUE] në Prishtinë, të cilen e përfaqson sipas autorizimit av. [REDAKTUE] ka paraqitur padi në këte Gjykatë ndaj të paditurit [REDAKTUE] nga Ferizaji [REDAKTUE] baza e kontestit kthimi i borgjit në shumen prej 140.00 Euro/Njëqind e dyzet euro/.

Gjykata në pajtim me nenin 394 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, këtë paditurit i a ka dërguar një kopje të padisë dhe udhezimin për përgjegje në padi, të cilat i ka pranuar me datën 19.02.2016, edhe pse i paditurit [REDAKTUE] nga Ferizai [REDAKTUE] Ka qenë i obliguar që në afatin prej 15 ditësh të bëjë përgjegjëjën në padi, i njëjtë nuk e ka shfrytzuar afatin.

Për këtë arsyet ka vendosur si në dispozitivin të këtij Aktgjykimi e konformë nenit 150 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, me të cilin e ka aprovuar kërkespadinë e paditëses Kompania e Sigurimeve [REDAKTUE], rruga [REDAKTUE] në Prishtinë, të cilen e përfaqson sipas autorizimit av. [REDAKTUE]


**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

C.nr.501/15

Me daten 12.04.2016.

Sek.juridike  
Ardita Tasholli

**Këshilla Juridike:** kunder ketij Aktgjykimin, palet e paknaqura mundët e ushtrojn Ankesë në afatin prej 15 ditësh, në Gjykaten e Apelit në Prishtinë/ Apërmësë kësaj Gjykate.



Gjyqtari,  
Misin Frangu